



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Habib Zogaj
Drejtore
Radio Malisheva
R056
Malishevë

Vendimi LIC: 2008/02
Ref: 0806/0817/CIMC/ni

VENDIM

lidhur me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Malishevës

Fakte

1. Parashtruesi i kërkesës është subjekt transmetues privat në Malishevë. Ky subjekt transmetues ka pranuar licencën e modifikuar nga Komisioneri i Përkohshëm për Media më 27 maj 2005.
2. Më 9 qershor 2008, Komisioni i Pavarur për Media ka pranuar një kërkesë nga drejtori i Radio Malishevës z. Habib Zogaj lidhur me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit, duke kaluar nga ai i tanishmi që gjendet në Qendrën Rinore dhe Tregtare "Dardania" për në lokacionin për të cilin ka qenë fillimisht i licencuar i cili gjendet në lagjen "Mirdita - te Tregu i Plaçkave" pn.
3. Radio Malisheva kërkon që të kthehet në vendin e ish-licencuar me arsyetimin se në ndërtesën në të cilën gjendet aktualisht lokacioni i sistemit të transmetimit të saj është duke u bërë mbindërtim.

Arsyetimi

4. Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-15 është themeluar Komisioni i Pavarur për Media dhe Transmetim i cili është autoriteti i vetëm në territorin e Kosovës për rregullimin e Spektrit të Frekuencave të Transmetimit, për lëshimin e licencave dhe mbledhjen e taksave për licencë transmetimi.
5. Sipas vlerësimit të inxhinierit të Divizionit të Menaxhimit të Frekuencor (DMF) të KPM-së, të bërë më 11 qershor 2008, ndryshimi i lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Malishevës, duke kaluar në lokacionin e mëparshëm të licencuar në koordinatat gjeografike N 42° 29' 12" dhe E 20° 45' 05" nuk do të

Ruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Prishtina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Prishtina

ketë ndryshime në zonën e mbulimit të Radio Malishevës, dhe nuk paraqet ndryshime të Pjesës 2 dhe 4 të licencës së KPM-së.


6. Prandaj, DMF vlerëson se kalimi i Radio Malishevës në vendin e propozuar me anë të kërkesës dhe transmetimi në koordinatat e lartpërmendura është në pajtim me Kushtet dhe Termet e Licencës së KPM-së.
7. Arsytimi nga ana e parashtruesit të kërkesës është i mjaftueshëm për Këshillin e KPM-së që ta aprovojë ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit. Gjithashtu, Këshilli i KPM-së merr parasysh edhe faktin që i licencuar kërkon të kaloj në vendin për të cilin fillimisht ka qenë i licencuar dhe se transmetimi do të bëhet sipas koordinatave të cekura më lartë.
8. Këshilli i KPM-së në pajtim me vlerësimin e lartpërmendur nxjerr këtë:

Vendim

9. Këshilli i KPM-së pajtohet me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Malishevës duke kaluar nga Qendra Rinore dhe Tregtare "Dardania" në lagjen "Mirdita – te Tregu i Plaçkave", pn sipas koordinatave të përcaktuara nga DMF.
10. Këshilli i KPM-së konkludon se me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit nuk do të ketë ndryshime të Pjesës 2 dhe 4 të licencës s Radio Malishevës.
11. Këshilli i KPM-së pajtohet që Radio Malisheva të ndërrojë lokacionin e sistemit të transmetimit, përkohësisht deri në procesin e ri-licencimit.

Lëshimi i Vendimit


12. Këshilli i KPM-së lëshon këtë vendim.


Argjentina Grazhdani
Kryesuese e Këshillit të KPM-së.

16/06/2008
datë

Vërtetim

Me këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.


Nafle Selimaj Krasniqi
Shefë Ekzekutive e KPM-së



16.06.2008
datë